



Letër këshilluese 2006-2

11 Maj 2006

**Praktika të pa shëndosha dhe të pa sigurta të bankave**

Gjatë periudhës së ekzaminimit, BPK-ja ka vërejtur disa praktika të cilat i ka konsideruar si të pashëndosha dhe të pasigurta. Ne po ju ofrojmë këto letra që ju të jeni në dijeni dhe të informuar në lidhje me këtë. Ne duam të ju sugjerojmë se Drejtorët e Përgjithshëm duhet që t'i rishikojnë praktikatat e bankave të tyre në mënyrë që këto të mos paraqiten ose të mos përsëriten prapë. Herë pas herë BPK-ja do të azhurojë këtë listë ashtu sikurse praktikatat të zbulohen gjatë aktiviteteve të mbikqyrjes. Këto praktika do të kritikohen në raportet e ekzaminimit dhe mund të merren për bazë për aktivitetet e ardhshme të mbikqyrjes të BPK-së.

**Auditim të pamjaftueshëm/kontrolli i parave të gatshme.** BPK-ja ka përcaktuar se disa menaxherë të degëve kanë qenë duke udhëhequr libra privatë të kredive jashtë parave të gatshme në degët e tyre, me çrast kanë raportuar rrejshëm/fals shumën totale të parave të gatshme në zyrën qendrore.

**Depozitat “reciproke” me bankat korrespondente.** BPK-ja ka vërejtur se disa banka kane plasuar fondet e tyre në depozita të bankave korespondente, me qëllim të korespondencës ato banka i kanë plasuar depozitat ose një pjesë të vogël të tyre si kthim prapa në bankat kosovare. Kjo ka ndikuar në zmadhimin e depozitave dhe në mënyrë të falsifikuar ka përmirësuar raportin kredi me depozita. Gjithashtu ka shërbyer për të zmadhuar mjetet likuide në atë mënyrë që bilancet koresponduese nuk kanë qenë të gatshme për të kënaqur detyrimet e përgjithshme. Për më tepër, këto transaksione kane qenë me një shkallë të interesit të ndryshueshme dhe që kanë qenë të pafavorshme për bankën kosovare.

**Raportimi i bilanceve koresponduese të bllokuara si mjete likuide.** Është zbuluar se bankat kanë raportuar si bilance të lira të gjithë shumën e llogarive të bankave korrespondente, e që në fakt një pjesë e madhe e bilancit me një bankë koresponduese ka mundur të jetë e bllokuar për të siguruar garantues apo transaksione të reja kreditore. Kjo ka shërbyer për të zmadhuar shumën e vërtetë të mjeteve likuide të gatshme për të përmbushur detyrimet e përgjithshme.

**Transferi i fondeve të klientëve pa ndonjë hyrje të kontabilitetit për kompenzim .** Shembuj të tillë janë identifikuar kur një bankë ka transferuar fonde në emër të klientëve, por që nuk e ka ngarkuar llogarinë e klientit nëse nuk ka pasur fonde të mjaftueshme. Në vend të saj, nuk është bërë ndonjë hyrje kontabiliteti për kompenzim, apo deficitit është bartur në

ndonjë llogari të përkohshme. Këto transaksione e kanë nënvlerësuar huadhënjen nga bankat.

**Pagesa e kredive të vjetra me kredi të reja/kredi të ristrukturuara pa ndonjë ndryshim në faktorët kreditor për të mbështetur kredinë e re/të ristrukturuar.** Zakonisht avansimet e reja janë kryer për t'ju shmangur apo korrigjuar delikuecën dhe për të mënjeluar ekspozimin nga klasifikimi dhe nga kërkesat për rezerva shtesë. Këto transaksione kanë rezultuar në raportime të rrejshme të kualitetit të mjeteve, nevojave të provizionit dhe të të ardhurave.

**Njohja e të hyrave nga interesi mbi kreditë delikuede të ristrukturuara.** Kreditë e reja apo të ristrukturuara, të përmendura më lartë, shpesh e kanë kapitalizuar interesin delikuent në shumën e re të kryegjësë. Këto transaksione kanë zmadhuar të hyrat nga interesi dhe së fundi edhe kapitalin.

**Kthimi i provizionit në bazë të ristrukturimit pa asnjë ndryshim në faktorët kreditorë për të garantuar kthimin e rezervës.** Këto transaksione kanë synuar të zmadhojnë të hyrat nëpërmes rikrijimit të provizionit.

**Dhënia e huave/linjave kreditore për kapital punues/në afat kohor prej 18 muajve deri në 3 vjet.** BPK-ja konsideron se avanset e këtilla nuk janë për kapital punues. Shumica e linjave/huave janë tërhequr plotësisht në fillim dhe kanë ngelur në shumën e tyre të tërhequr deri në afatin e caktuar të maturimit. Asnjë dokumentacion mbështetës nuk ka evidentuar nevojat specifike të kapitalit punues apo ndonjë analizë të qarkullimit të mjeteve punuese në bazë të së cilave pagesa të përkohëshme të avanseve mund të priten apo të kërkohen. BPK-ja konsideron këto linja të këtilla me termin kredi duhet të strukturohen në përputhje me rrethanat. Kjo reflekton një administrim të dobët të kreditimit.

**Shpesh huamarrësve iu janë dhënë në të njëjtën kohë dy apo edhe tri linja kreditore për kapital punues, ose në mënyrë të konsiderueshme dhe të vazhdueshme janë lejuar tej linja kreditore .** Shpesh nuk janë hasur analiza formale apo aprovime në lidhje me tej linjat kreditore (over lines). Ky rast reflekton një administrim të dobët, analizë të pamjaftueshme të nevojave të klientëve si dhe mungesë kontrolli mbi kreditë.

**Analizë e pamjaftueshme / joekzistuese të rrjedhës së parave të huamarrësve që ka kërkuar riprogramim të shpeshtë.** Kjo reflekton gjithashtu një administrim të dobët të kredive edhe mungesë të kuptimit të bizneseve të klientëve.

**Dokumentacion i pamjaftueshëm në lidhje me procedimin /procesimin e kredive.** Faturat para dhe pas avansit/huasë që nuk janë kërkuar, nuk kanë qenë në përputhshmëri me biznesin e huamarrësit apo kanë qenë të falsifikuara. Disbursimet e kredisë shpeshë janë bërë drejtëpërdrejtë në llogarinë depozituese të klientit me tërheqje në para të gatshme nga ana e klientit; asnjë transfer i shumës së lejuar të kredisë nuk ju është bërë palës shitëse të klientit. Transaksionet bëjnë që bankat të mos kenë kontroll në përdorimin e kredive apo të vërtetojnë/vlerësojnë përdorimin e duhur të shumës së kredisë. Nuk ka asnjë kontrollë auditimi. Këto transaksione gjithashtu hapin mundësinë që banka ti ekspozohet rezikut të shpërlarjes së parave.

**Mungesë e informacionit të mjaftueshëm financiar në bazë të të cilave bazohet kredia.** Bankat vazhdimisht kanë dështuar të arrijnë të sigurojnë informata financiare të besueshme dhe të kuptueshme në lidhje me humarrësin apo të verifikojnë përmbajtjen e informatave të pasqyrave financiare. BPK-ja vlerëson se shumica e informatave financiare janë të një kualiteti të dobët dhe nuk janë të analizuara. Në disa raste, vërtetësia e pasqyrave financiare vëhet në pikëpyetje.

**Huadhënja ndaj kolateralit sesa pamundësisë së huamarrësit për të paguar borxhin.** Një praktikë e tillë e rrit rrezikun e kredive shumë. Një gjë e tillë forcohet nga fakti se disa banka kanë dështuar të verifikojnë ekzistencën, kushtet dhe vlerën e kolateralit dhe / apo kanë dështuar të regjistrojnë marrëveshjen e pengut.

**Proceset e dobëta të rishqyrtimit të brendshëm të kredive dhe të klasifikimit.** BPK-ja ka vërejtur se disa banka klasifikojnë ekspozimet pikërisht në bazë të statusit të delikuencës, në vend se të bëjnë atë në bazë të vlerësimit të kushteve të përgjithshme të kredisë dhe kredimarrësit. Kjo metodologji është qartë e pamjaftueshme për të identifikuar me kohë dhe saktësisht problemet e mundshme të kredive dhe nevojat për provizion.

**Kreditimi i personave të brendshëm në baza preferenciale.** Shpesh, preferenca ka marrë formën e tillë që ka ndikuar në zgjatjen e periudhës, kamata më të ulta, zgjatjen e afateve të maturimit apo dështimin që të detyrojnë kërkesat e pagesave. Disa kredi nuk do të duhej të lejoreshin huamarrësve të ashtuquajtur me një fjalë “sa të arrijë krahu” me vlerë të barabartë të aftësisë kreditore.

**Huadhënja personave të lidhur “nominees” për t’ju shmangur kufijve ligjor (shpesh për të personat e brendshëm).** Një praktikë e tillë ka dalur të jetë e zakonshme. Ka kompani që janë krijuar vetëm e vetëm për të marrë kredi të cilat i transferohen një pale tjetër (zakonisht një drejtori, aksionari apo një biznesi të afërt të ndërlidhur). Në disa raste, biznese jo legjitime të ndërlidhura kanë marrë kredi dhe kanë transferuar një pjesë të fondit tek ndonjë person i brendshëm. Në rastin e fundit, BPK-ja shpesh nuk ka hasur bashkëpunim ekonomik në mes të palëve që e mbështesin transferin në fjalë.

**Dështim për t’ju bindur urdhërave dhe marrëveshjeve të mbikqyrjes.** Në të vërtetë, gjatë vizitave pasuese në vend apo monitorimit nga jashtë (off site) është zbuluar se qëllimisht ka pasur mosrespektim apo shmangie të kërkesave të parashtruara nga BPK-ja.